

KËRKESË
Nr. 288/7, datë 13.6.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 144, datë 22.2.2017, të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikualifikimi urban i qytetit të Pukës’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Pukë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasurinë e paluajtshme, pronë private, i cili do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

- Për objektin e llojit “njësi”, vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Personi që preket nga ky projekt i cili ka emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Pukë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,528,477 (një milion e pesëqind e njëzetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARIT PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILIT PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 144, DATË 22.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTT ‘RIKUALIFIKIMI URBAN I QYTETIT TË PUKËS’”

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: “ndërtesë”.

Nr.	Të dhënat e pronës									
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale e objektit të shpronësuar m ²	Sip. që shpronësohet e objektit m ²	Vlera e objektit me situacion lekë	Shënime
1	Gezim Mustaf Kurtalia			3069	1/422-N	Njësi	54.72	54.72	1,528,477	Konfirmuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Pukë
Sipërfaqe totale shpronësimi m ²								54.72		
Vlera totale paraprake e shpronësimit në lekë									1.528.477	

Shënime.

1. Për objektin e llojit “njësi”, vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.